



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Agro Invest 1" Sh.P.K. të datës 06.07.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 02.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "121 Pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimit atmosferik lot 4" me nr. të prokurimit 616-24-4344-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Agro Invest 1" Sh.P.K. të datës 06.07.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 02.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "121 Pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimit atmosferik lot 4" me nr. të prokurimit 616-24-4344-5-2-1 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 02.07.2024 i autoritetit kontraktues lidhur me lot 4 të këtij aktiviteti të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit lotin 4 nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Agro Invest 1" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 06.07.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 02.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "121 Pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimit atmosferik lot 4" me nr. të prokurimit 616-24-4344-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi nr. 1 - "1. Ne dosje te tenderit eshte kerkuar: Një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik me më se paku tre vite përvojë pune pas diplomimit per llot I,II,III dhe llot IV dhe si deshmi eshte kerkuar Diplomë universitare - Kopje e Noterizuar; Biografia (CV-në) Kontratën e punës të përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët; Grupi OE ka dorezuar ing. Avni Lohaj i cili nuk e ka te nenshkruar CV-ne (faktet te bashkangjitura ne attach)".

Pretendimi nr. 2 - "2. Ne dosje te tenderit eshte kerkuar: .Puntorë fizik 5(pesë) per llot I,II,III dhe llot IV ku si deshmi eshte kerkuar Kontratën e punës të përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët; Grupi OE ka dorezuar vetem nje liste te punetoreve teknik ku mungojne kontratat ose parakontratat me punetoret (faktet te bashkangjitura ne attach)".

Pretendimi nr. 3 - "3. Ne dosje te tenderit eshte kerkuar: për llot IV LLOTO 4 Eskavator 4x4, me lugë ngarkuese para dhe mbrapa.(tre)3 Kamion me peshe bartëse minim 10m3(Një)1 Ngarkues?9.0 ton (Një) 1 Grupi OE ka dorzuar nje list te pergjithshme te makinerise jo specifike per kete tender, gjithashtu ka dorzuar eskavator te cilet nuk kan lug ngarkuese para dhe mbrapa dhe nuk jane 4x4 pra jane eskavatore te thjeshte dhe jo sic eshte kerkuar ne FTD (faktet te bashkangjitura ne attach)".

Lidhur me pretendimin nr. 1 - në dosjen e tenderit nuk është cekur shprehimisht që CV duhet të jetë e nënshkruar megjithëse lidhur me këtë pjesë AK ka mundur që të kërkoj sqarime shtesë për të konfirmuar vërtetësinë e dokumentit. Prandaj pretendimi është vetëm pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 2 - nga administrimi me ofertën e tenderuesit të rekomanduar është gjetur se nuk janë bashkangjitur kontratat/marrëveshjet për të gjithë punonjësit fizik sipas dosjes së tenderit dhe listës përkatëse të stafit. Prandaj ky pretendim është i bazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 3 - nga administrimi me ofertën e tenderuesit të rekomanduar është gjetur se tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar një eskavator pa lugë ngarkuese para dhe mbrapa dhe që nuk është 4x4 por është vetëm eskavator i thjeshtë. Prandaj edhe ky pretendim është i bazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 15.07.2024

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.